

V E N D I M
Nr.232, datë 24.5.1994

**PËR PRIVATIZIMIN E SË DREJTËS SHETËTËRORE SHQIPTARE DHE TRANSFERIMIN
E DHËNIA ME QIRA E PASURISË NË NDËRMARRJET E PËRBASHKËTA**

Me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të përgjithshme për privatizimin e së drejtës shtetërore shqiptare.

Përgatitjet për privatizimin e të drejtave shtetërore shqiptare në ndërmarrjet e përbashkëta (shoqëritë tregtare me ortak shtetëror shqiptar) do të bëhen në analogji me privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore me po ato procedura dhe nga po ato organe. Procesi i privatizimit duhet të nisët nga ortaku shtetëror shqiptar i përcaktuar në nenin 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare me ortakë të tjerë”.

Vlera aktuale minimale e së drejtës shtetërore shqiptare në ndërmarrjen e përbashkët përcaktohet si pjesë e VAMI të gjithë ndërmarrjes së përbashkët, duke marrë parasysh si aktet e themelimit të ndërmarrjes në momentin e krijimit të saj, ashtu edhe ndryshimet e tyre të mëvonshme, si gjendjen kontabël në momentin e privatizimit. Për llogaritjen e VAMI të ndërmarrjes zbatohet vendimi i Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994 “Për kriteret e vlerësimit të pasurisë shtetërore që privatizohet”, ose pika 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare me ortakë të tjerë”, për ato ndërmarrje të sapoformuara, si dhe aktet përkatëse, për vlerësimin e gjendjes kontabël.

Për të zbatuar përkrahjen që u bëhet në privatizim disa grupeve (punonjësit e ndërmarrjes, ish të përndjekurit, ish-pronarët) do të merren në konsideratë lidhja e tyre me pjesët e ndërmarrjeve shtetërore që janë futur në ndërmarrjen e përbashkët, deri një vit para nënshkrimit të aktit të themelimit të saj, dhe jo lidhja e tyre me ndërmarrjen e përbashkët.

Rolin e ekspertit, të propozuar nga pala shtetërore shqiptare, në kuptimin e nenit 11 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, e luan tërësia e organeve përkatëse që angazhohen në privatizimin në Shqipëri. Këto organe janë përcaktuar në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, dhe në aktet nënligjore përkatëse. Ato janë Agjencia Kombëtare e Privatizimit (me degët e bordet e saj) dhe Komisioni Përgatitor i Procesit të Privatizimit pranë Ministrisë së Financave (me nënkomisionet dhe drejtoritë e privatizimit etj.).

2. Privatizimi i së drejtës shtetërore shqiptare në ndërmarrjet e përbashkëta të themeluara (regjistruara) gjer më 1 qershor 1993.

2.1 Mënyra e privatizimit

Nëse nuk bien qartë në kundërshtim me aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, të nënshkruara para datës 1 qershor 1993, ose janë dakord edhe ortakët joshetërorë shqiptarë, privatizimi bëhet si vijon:

Kur vlera aktuale minimale e të drejtave shtetërore shqiptare në ndërmarrjen e përbashkët është deri në kundërvleftën në lekë të 500 mijë USD, privatizimi i saj bëhet duke zbatuar të njëjtat procedura dhe nga po ato organe që parashikon vendimi i Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme”. Në zbatim të atij vendimi ç’është thënë për “ndërmarrjen” vlen për “të drejtat shtetërore shqiptare në ndërmarrjen e përbashkët”. Nuk zbatohen pjesë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, në qoftë se bien në kundërshtim me aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët të nënshkruara para datës 1 qershor 1993.

Kur vlera aktuale minimale e të drejtave shtetërore shqiptare në ndërmarrjen e përbashkët është mbi kundërvleftën në lekë të 500 mijë USD, privatizimi i saj mund të bëhet edhe sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.248, datë 27.5.1993 (edhe duke bërë ndarje në pjesë të së drejtës shtetërore shqiptare siç rekomandohet në pikën 3.3 të këtij vendimi), si dhe duke përdorur mënyrat e privatizimit të tjera, si me aksione etj.

2.2. E drejta e parablerjes

Ortakët e ndërmarrjes së përbashkët joshitetore shqiptare gëzojnë të drejtën e parablerjes me çmimet e tregut. Prandaj nuk zbatohet pika 8 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993. Kërkesa e tyre për të blerë objektin duhet të bëhet brenda afateve të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, si dhe shoqërohet me vërtetimin e pagesës së 10 për qind të vlerës aktuale minimale të të drejtave shtetërore shqiptare të ndërmarrjes së përbashkët që privatizohet.

2.3 Shitja në favor të ortakëve

Procedura e privatizimit zhvillohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 (ose në mënyrë tjetër të vendosur shprehimisht), derisa të përcaktohet një “kandidat për ortak” dhe çmimi i shitjes që do të konsiderohet “çmimi i tregut”. Para fillimit të zbatimit të procedurave të përcaktuara në pikën 18 e në vazhdim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 (përkatësisht të transferimit të pronës), dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit i ofron të drejtën e parablerjes të së drejtës shtetërore shqiptare me atë çmim të tregut të përcaktuar më sipër ortakëve të ndërmarrjes së përbashkët që s’janë shtetërore shqiptare. Pranimi i blerjes nga këta ortakë fiksohet me shkrim dhe me firmën e tyre nga dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe vazhdohet të procedohet nga pika 18 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, me ata, duke lajmëruar ndërkohë “kandidatët për ortakë” se të drejtat e shtetit shqiptar u shiten ortakëve të ndërmarrjes së përbashkët.

2.4 Shitja të tretëve

Në rast se ortakët e ndërmarrjes së përbashkët, që nuk janë shtetërore shqiptare, nuk pranojnë ta blejnë, refuzimi regjistrohet e arkivohet në degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe vazhdohet të procedohet për privatizim që nga pika 18 (pagesa e çmimit të shitjes) e mbrapa e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, në favor të kandidatëve për ortakë të përcaktuar më lart.

2.5 Të ardhurat nga privatizimi

Të ardhurat nga privatizimi i të drejtave shtetërore shqiptare trajtohen njësoj si të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Kur privatizimi kryhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, nuk aplikohet korregjimi i të ardhurave më 4 për qind e 6 për qind, siç kërkohet në paragrafin e katërt deri të shtatë të atij vendimi.

3. Privatizimi i së drejtës shtetërore shqiptare në ndërmarrjet e përbashkëta të themeluara (regjistruara) pas datës 1 qershor 1993.

3.1 Mënyra e privatizimit

Privatizimi bëhet në analogji me sa u tha më lart, por me disa specifika si më poshtë. (Për ndërmarrjet e krijuara pas datës 11.3.1994, të hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare me ortakë të tjerë”, nuk zbatohen pikat 3.3, 3.4 etj. më poshtë, në ato pjesë ku kërkohet “konsensus” e “rënie dakord” nga ortakët e tjerë, meqë “konsensusi” dhe “rënie dakord” është e konsumuar për ato ndërmarrje; para nënshkrimit të akteve të themelimit, ortakët kanë rënë dakord që privatizimi do të bëhet siç thuhet, meqë kërkesat e vendimit “janë përfshirë në aktet e themelimit të atyre shoqërive”, gjë që përputhet me sa thuhet në pjesët e tjera të këtij vendimi).

3.2 E drejta e parablerjes

E drejta e parablerjes nuk u jepet ortakëve, por u lihet vetëm ish-pronarëve. Ish-pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes vetëm në masën e vlerës së aktualizuar të objektit që ndodhej në truallin ish-pronë e tij, në gjendjen në kohën e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët. Vlera e aktualizuar e objektit merret sa ç’është përfshirë në aktin e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, e korrigjuar me indeksin e çmimeve në momentin e privatizimit.

Kur diferenca mes vlerës aktuale minimale të së drejtës shtetërore shqiptare dhe vlerës së aktualizuar të objektit është jo më e madhe se 20 për qind e vlerës së aktualizuar të objektit, ish-pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes për gjithë të drejtën shtetërore shqiptare, me vlerën aktuale minimale të saj.

Kur diferenca mes vlerës aktuale minimale të së drejtës shtetërore shqiptare dhe vlerës së aktualizuar të objektit është më e madhe se 20 për qind e vlerës së objektit të ndërtuar mbi truallin e ish-pronarit, vlera e së drejtës së shtetit shqiptar ndahet në dy pjesë, njëra me madhësi sa vlera e aktualizuar e objektit dhe tjetra me vlerën që mbetet. Ish-pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes vetëm për vlerën e aktualizuar të objektit. Pjesa që mbetet vazhdon privatizimin në mënyrë të pavarur,

e çliruar nga e drejta e parablerjes. Të drejtat e detyrimet ndahen brenda pjesës shtetërore shqiptare përpjesëtimisht raportet mes vlerës së aktualizuar të objektit dhe vlerës aktuale minimale të gjithë së drejtës shtetërore shqiptare, pavarësisht se sa do të shiten secila.

3.3 Ndarja në pjesë

Në konsensus me ortakët, për të lehtësuar privatizimin, e drejta shtetërore shqiptare mund të ndahet në disa pjesë. Paraprakisht përcaktohet për secilën pjesë se sa për qind të së drejtës shtetërore shqiptare përbën ajo në analogji me sa u tha më lart për objektin mbi truallin ish-pronë private. Fakti se sa do të arrijë të shiten secila pjesë nuk do ta ndryshojë përqindjen që zë ajo në të drejtën shtetërore shqiptare të paracaktuar.

3.4 Zgjidhja e mosmarrëveshjes me ortakët.

Kur aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët bien në kundërshtim me këtë lloj transferimi të të drejtave të ortakut shtetëror shqiptar ose kundërshtohet nga ortakët joshetëror shqiptar, atëherë veprohet si vijon:

a) Për ndërmarrjet e përbashkëta, ku vlera aktuale minimale e të drejtave shtetërore shqiptare është jo më e madhe se kundërvlefata në lekë e 500 000 USD.

Procesi i privatizimit nis sipas paragrafit të parë të pikës 3 dhe vazhdon pa ndërprerje deri në pikën 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993. Në të njëjtën kohë, kur është nevoja, negociohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe ortakut shtetëror shqiptar, nga njëra anë dhe ortakëve të tjerë, që nuk janë shtetërore shqiptare, nga ana tjetër, që të pranojnë të bëhen ndryshimet e mundshme në aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, me qëllim që një privatizim i tillë juridikisht të mos bjerë në kundërshtim me këto akte.

Në rast se ata nuk bien dakord që të bëhen ndryshimet përkatëse në statut dhe aktet e tjera, në qoftë se kandidati (a kandidatët) për ortak (ish-pronarë truallit, persona që kanë fituar ankandin ose persona të caktuar nga bordi) bëjnë kërkesë me shkrim (duke pranuar të gjitha pasojat ekonomike që mund të kenë jepet më poshtë), ortakët shtetëror shqiptar bën padi në gjykatë që të bëhen ndryshimet përkatëse në aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, në mënyrë që të mund të kryhet privatizimi siç është shpjeguar më lart, në paragrafin e parë të pikës 3.

Si bazë juridike për prishjen e asaj pjese eventuale të akteve të themelimit, që bëhen pengesë për privatizimin si më lart, shërben, në radhë të parë, fakti i shmangies të së drejtës së parablerjes të ish-pronarëve, si dhe paragjykimi i mënyrës së privatizimit, duke rënë kështu në kundërshtim përkatësisht me ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme”. Të dy këto akte kanë hyrë në fuqi që më 1.6.1993. Së dyti, edhe çdo shkelje a parregullsi tjetër e mundshme, e vërejtur në aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, mund të jenë argumente në gjyq.

Në të gjitha rastet, sido që të jetë vendimi i gjyqit, shpenzimet e gjyqit dhe shpenzimet e tjera që burojnë si rezultat i këtij procesi gjyqësor, ato që rëndojnë mbi palën ortak shtetëror shqiptar, paguhen nga ai, por përballohen (rimburohen) nga kandidatët për ortakë. Vetëm pasi është marrë vendimi i formës së prerë nga gjykata dhe të jenë bërë të gjitha pagesat për shpenzimet e mësipërme (ortakut shtetëror shqiptar nga kandidatët për ortakë), vazhdohet procedura e privatizimit që nga pika 18 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, në favor të kandidatit për ortak.

b) Për ndërmarrjet e përbashkëta ku vlera aktuale minimale e të drejtave shtetërore shqiptare është më e madhe se kundërvlefata në lekë e 500 000 USD.

Në rast se ortakët e tjerë që nuk janë shtetërorë shqiptarë, nuk bien dakord që të bëhen ndryshimet përkatëse në statut dhe aktet e tjera të themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, atëherë për privatizim veprohet pa rënë ndesh me këto akte.

4. Detyrimet e blerësit të së drejtës shtetërore shqiptare në ndërmarrjen e përbashkët.

Kushdo që do të jetë blerës i të drejtave të shtetit shqiptar në ndërmarrjen e përbashkët, i nënshtrohet procedurave të pagesës që përcaktohen me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993.

Edhe në rastin kur blerësit nuk janë ortakët e ndërmarrjes së përbashkët ata, me t'u bërë ortakë, marrin përsipër të gjitha të drejtat e detyrimet që kishte ortakët shtetëror shqiptar në këtë ndërmarrje të përbashkët, sipas statutit e akteve të tjera të themelimit të ndërmarrjes së përbashkët dhe ndryshimeve të mundshme të bëra deri në momentin e privatizimit. Çdo ndryshim i bërë pas datës 11 mars 1994, kur ka hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave nr.93, datë 28.2.1994 “Për bashkimin

e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare me ortakë të tjerë”, duhet të jetë në përputhje me atë vendim.

5. Transferimi dhe dhënia me qira e pasurisë së ndërmarrjes së përbashkët.

5.1 Pasuria që nuk transferohet a jepet me qira drejtpërdrejt nga vetë ndërmarrjet.

Ndërmarrja e përbashkët, ku pjesa shtetërore shqiptare në kapitalin themelor të saj është më e madhe se 20 për qind, lejohet të transferojë pjesë të pasurisë së paluajtshme (si reparte, godina etj.) dhe makineri e pajisje të instaluar në to, ose edhe makineri të shkëputura me vlerë më të madhe se kundërvlefëta në lekë e 10 000 USD, si dhe mund t’i japë ato me qira vetëm nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit e jo në persona juridikë që janë shtetërorë shqiptarë.

5.2 Vlerësimi, privatizimi dhe dhënia me qira

Kjo pasuri e përcaktuar si më sipër, shkurtimisht do të emërtohet “pasuri” në vijim të këtij vendimi. Ky transferim trajtohet si privatizim dhe kryhet në bazë të të gjitha rregullave të privatizimit. Dokumentet e vlerësimit të kësaj “pasurie”, pasi kalojnë në hallka të njëjta me ato ku kalojnë ato të ndërmarrjeve shtetërore, i dërgohen degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit të rrethit ku ndodhet kjo “pasuri”. Çmimi minimal i shitjes së “pasurisë” ose qiraja minimale duhet të miratohet edhe nga ortakët joshetërorë shqiptarë. Dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit fillon procedurën e privatizimit duke e trajtuar “pasurinë” njësoj sikur të ishte një ndërmarrje shtetërore që do të privatizohet, në kuptimin dhe sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, ose vendimit të Këshillit të Ministrave nr.386, datë 26.7.1993 ose ndonjë akti tjetër përkatës.

5.3 Ndarja e të ardhurave

Të ardhurat nga transferimi i “pasurisë” ose nga qiraja ndahen përpjesëtimisht ndërmjet ortakëve, në përpjesëtim me pjesët e kapitalit themelor të ndërmarrjes së përbashkët.

5.4 Të ardhurat nga transferimi

Pjesa e të ardhurave që i takon ortakut shtetëror shqiptar, në rastet kur privatizimi është bërë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993, ndahen sipas atij vendimi. Nuk zbatohet korrigjimi i të ardhurave nga privatizimi me 4 për qind e përkatësisht 6 për qind, siç kërkohet në paragrafin e katërt deri të shtatë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993.

5.5 Të ardhurat nga qiraja

Pjesa e të ardhurave nga qiraja që i takon ortakut shtetëror shqiptar, ndahet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.386, datë 26.7.1993; të ardhurat që i takojnë sipas atij vendimi “ndërmarrjes apo institucionit shtetëror” i kalojnë organit që ka atributet e ortakut shtetëror shqiptar.

5.6. Respektimi i akteve të themelimit

Nuk zbatohen procedurat që bien qartë në kundërshtim me aktet e themelimit të ndërmarrjes së përbashkët, të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Detyra për organet shtetërore

Ngarkohen të gjitha dikasteret, Agjencia e Ristrukturimit të Ndërmarrjeve, korporatat, pushteti lokal etj. që kanë atributet e ortakut shtetëror shqiptar, të fillojnë menjëherë veprimet për zbatimin e këtij vendimi, përveç ndërmarrjeve që kryejnë veprimtari në degët me rëndësi të veçantë për ekonominë, të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi